

DHOMA AMERIKANE E TREGETISE



AMERICAN CHAMBER OF COMMERCE

RAPORT

mbi

problemet në lidhje me çështjet doganore

dhe

disa propozime për ndryshime në legjislacionin doganor

DHJETOR 2013

PËRMBAJTJA

HYRJE

I. PROBLEME TË LIDHURA ME ZBATIMIN E LEGJISLACIONIT DOGANOR

III. KOMUNIKIMI NDËRINSTITUCIONAL

IV. ÇËSHTJE TË LIDHURA ME FORMIMIN PROFESIONAL DHE ETIKËN

IV. PROPOZIME PËR NDRYSHIME NË LEGJISLACION

HYRJJE

Komiteti i Taksave dhe Ligjeve të Dhomës Amerikane të Tregtisë ("AmCham") ka përgatitur këtë Raport përmbledhës të problemeve dhe sygjertimeve të anëtarëve ("Raporti"). Problemet e shtjelluara më poshtë janë fryt i një komunikimi të brendshëm me të gjithë anëtarët e AmCham të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre tregtare në Shqipëri, vijnë nga industri të ndryshme, dhe nga sipërmarrje të madhesive të ndryshme, janë mbledhur nga komunikimet e mëparshme përkatëse të AmCham. Ato janë edhe fryt i diskutimit të brendshëm të anëtarëve të Komitetit të Taksave dhe Ligjeve të AmCham, dhe i diskutimeve të zhvilluara gjatë Forumit të Anëtarëve me DPD të mbajtur më datë 26 Nëntor 2013.

Raporti është konceptuar në mënyrë të tillë që të përmbledhë një gamë të gjerë problemesh të cilat janë të përbashkëta për shumicën e anëtarëve të AmCham, por edhe të trajtojë shqetësime specifike të cilat janë të tilla për shkak të industrisë përkatëse apo madhësisë përkatëse të sipërmarrjes së anëtarit të AmCham.

Raporti është ndarë në katër kapituj kryesore të cilat lidhen me **(A)** zbatimin e legjislacionit doganor, **(B)** marrëdhëniet përkatëse nderinstitucionale, **(C)** ceshtje të lidhura me profesionalizmin dhe etikën, si dhe **(D)** konstatime dhe propozime në lidhje me ndryshime të legjislacionit doganor.

Problemet në këtë Raport janë përshkruar jo me shumë hollësi pasi qëllimi ka qenë evidentimi i tyre, por në rast të marrjes parasysh të këtyre problemeve nga strukturat përkatëse shtetërore, AmCham është i gatshëm të japë me shumë hollësi mbi problemin dhe zgjidhjen përkatëse.

A. Probleme të lidhura me zbatimin e legjislacionit doganor

Ne lidhje me ceshtjet doganore anetaret e AmCham jane shprehur per problemet e meposhtme:

- Zbatimi i çmimeve të referencës për importet doganore bëhet në masë dhe pa u mbështetur në nenin 34¹ dhe në vazhdim të Kodit Doganor dhe dispozitat përkatëse të VKM nr. 205, datë 13.04.1999 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, i ndryshuar.

Ne listen e cmimeve te references vihet re qe per produkte me karakteristika te njejta por me marka tregtare te ndryshme ka cmime reference te ndryshme. Kjo liste duhet te permiresohet ne menyre qe te mos kemi ceshtje te zbatimit te ligjit ne menyre jo te barabarte.

Po keshtu, lista e te dhenave te disponueshme duhet te perditohet sa me shpesh te jete e mundur ne menyre qe te parashikojte cmime reference reale.

Duhet te realizohet publikimi i te dhenave te disponueshme per vleren doganore ne nje buletin te vecante sipas parashikimit te VKM nr.205 date 13.04.1999².

- Eshte raportuar se Drejtoria e Përgjithshme e Doganave nuk shprehet për kërkesat specifike me shkrim që paraqesin subjektet dhe në përgjigjet e këtij institucioni nuk gjen zgjidhje mbi themelin e kërkesave perkatese, por kryesisht referohen vetem dispozita ligjore duke e lënë cështjen të pazgjidhur.
- Mungesa e interpretimeve unifikuese nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ndikon në cënimin e sigurisë juridike te subjekteve doganore.
- Eshte konstatuar krijimi i praktikave doganore nga organet doganore vetem mbi bazen e legjislacionit specific doganor pa marre parasysh dispozitat e legjislacionit shqiptar perkates, vecanerisht Kodin e Procedurave Administrative, marreveshjet nderkombetare perkatese te nenshkruara/aderuara dhe ratifikuara nga Republika e Shqiperise, etj.
- Kerkohet zbatimi korrekt i marreveshjeve nderkombetare te nenshkruara/aderuara dhe ratifikuara nga Shqiperia qe kane lidhje me fushen e doganave, nderkohe qe kerkohet edhe ndergjegjesim i administrates doganore per detyrimin per konsiderimin e ketyre marreveshjeve si pjese e legjislacionit shqiptar.

¹ Kjo eshte evidentuar në mënyrë të përsëritur ne Raportet e Progresit te Komisionit të BE për Shqipërinë

² Pika 81.5 e Vendimit te Keshillit te Ministrave nr. 205.

- Pas vendosjes se sistemit elektronik te deklarimit doganor, eshte e natyrshme qe dokumentacioni manual te menjanohet. Megjithate ende, vazhdohet me kerkesa te tepruara per te dorezuar dokumentacionin edhe ne *hard copy* me arsyetimin se ende rregullat e organeve doganore parashikojne dhe nuk eshte hequr ende detyrimi per dorezim te dokumentacionit ne *hard copy* (p.sh: mbajtja manuale e regjistrit te magazines doganore).
- Jane raportuar probleme ne lidhje me zbatimin e legjislacionit ne menyre korrekte dhe te barabarte per subjekte te njejta. Subjekte me licence te njejte nuk i nenshkrohen te njejtave procedura te kontrollit dhe zhdoganimit, menjanimi i ketyre procedurave, etj., behet mbi baza diskriminuese.
- Eshte konstatuar mosmarrja parasysh nga organet doganore te zbritjeve/skontove te pasqyruara ne faturat e furnizuesve te huaj ne rastin e importimit te mallrave dhe, si rrjedhim, zbatimi i detyrimeve te TVSH-së ne import dhe detyrimeve doganore per një vlerë më të madhe sesa vlera realisht e paguar.
- Organet doganore nuk zbatojnë autorizimet e miratuara AKBN³ për përjashtimet nga TVSH, akciza, si dhe per detyrime të tjera doganore duke dubluar në këtë mënyrë kompetencat e AKBN duke u shprehur për çështje nderkohe qe trajtimi i themelit te ceshtjes i perket kesaj te fundit.
- Mosnjohja e Certifikatave të Origjinës të lëshuara nga organe të tjera (në përputhje të plotë me legjislacionin përkatës te shteteve perkatese) te ndryshme nga organet doganore të shteteve përkatëse, si dhe mosnjohja e Certifikatave të Cilësisë elektronike të lëshuara në përputhje me legjislacionin e vendit lëshues të Certifikatës.
- Verehet mungese e procedurave te thjeshtezuara per zhdoganimet e dergesave express.
- Kerkohet zgjidhja e problemeve te zhdoganimeve te dergesave private, edhe per qellime te ndikimit ne industrine postare:
 - Procesi i zhdoganimit akoma nuk eshte i thjeshte, por krijon vonesa.
 - Shtetasit e huaj qe jane rezidente ne Shqiperi dhe qe marrin pako private, apo shtetasit e huaj qe qendrojne perkohesisht, ne baze te procedurave aktuale kane veshtiresi te importojne dhe zhdoganojne dergesa per perdorim privat.

³ Agjensia Kombetare e Burimeve Natyrore (AKBN)

- Ceshtje te tranzitimit me toke ne Shqiperi: Sipas praktikave te tanishme, tranzitimi behet vetem me kamion te plote dhe nenkupton kalimin drejperdrejt nga nje pike doganore kufitare ne nje pike tjeter doganore kufitare. Por, subjektet nuk transportojne vetem dergesa te plota (Full Truck Load), por edhe te pjeseshme grupazhe apo kamion te pjesshem (Less than Truck Load). Tashme, nuk mund te transportohen transit grupazhe te ndryshme. Qe te kryhet ky lloj tranzitimi duhet prania e nje magazine doganore, ku mallrat grupohen sipas shteteve te destinacionit, dhe kryhet tranzitimi per ne shtetet e destinacionit. Nese kryen transporte grupazh me regjim transit ne Shqiperi, duhet qe me hyrjen e ketyre grupazheve ne kufirin Shqiptar te kalohen ne nje Terminal Tranzitimi (HUB) per tu tranzituar per ne vendin e destinacionit. Tashme, qe te behet kjo procedure organet doganore kerkojne qe cdo grupazh te kaloje ne kete magazine doganore dhe qe subjekti qe kryen transportin te beje deklaraten e tranzitit nga dogana kufitare hyrese ne magazinën doganore, terminalin e operimit ne Shqiperi, dhe subjekti te vendose NIPT-in e tij ne deklarate. Si rezultat, organet doganore dhe tatimore e konsiderojne si mall ne perkatesi te shoqerive te transportit per qellime te detyrimeve tatimore.
- Jane konstatuar vonesa te zhdoganimeve per qellime te eksportit; kerkohet sherbim 24 oresh dhe mundesi zhdoganimi edhe ne ditet e pushimeve javore dhe festave zyrtare.
- Eshte konstatuar qe inspektoret doganore aplikojne detyrime me te larta doganore duke mos perdorur kodet e duhura doganore sipas nomenklatures se mallrave ose duke ndryshuar kodet doganore nepermjet riklasifikimeve per mallra te caktuara.

B. KOMUNIKIMI NDERINSTITUCIONAL

Anetaret e AmCham jane shprehur edhe mbi nevojën per permiresimin e komunikimit nderinstitucional per te shmangur problemet e praktikës se perditshme me natyre doganore. Ne menyre te vecante:

- Verehet mungese komunikimi dhe koordinimi midis organeve tatimore dhe atyre doganore per qellime te perputhjes se te dhenave nga te dy sistemet (doganore dhe tatimore) per qellime te detyrimeve tatimore, etj.
- Te permiresohet komunikimi i administrates doganore shqiptare me administratat doganore te vendeve te tjera per qellime te deklarimeve, korrigjimeve te deklaratave

doganore, etj. Vecanerisht, kerkohet bashkepunim me administraten doganore te Kosoves per qellime te zgjatjes se orarit te punes ne pikat doganore me Shqiperine.

- Te rritet niveli i bashkepunimit midis Drejtorise se Pergjithshme te Doganave dhe Avokatit te Popullit per qellime te mbrojtjes se te drejtave te subjekteve doganore ne te gjitha nivelet e administrates publike perkatese.
- Kerkohet bashkepunim midis DPD dhe Inspektoriatit Qendror per qellime te mbrojtjes se pronesise industriale.
- Sugjerohet permiresimi i bashkepunimit midis DPD dhe Drejtorise se Pergjithshme te Metrologjise.

C. ÇESHTJE LIDHUR ME FORMIMIN PROFESIONAL DHE ETIKEN

Nga anetaret e AmCham jane identifikur edhe ceshtjet e meposhtme:

- Inspektorët e Zyrave Rajonale Doganore reflektojnë gjatë kontrolleve doganore mungesë të njohurive rreth legjislacionit perkates të zbatueshëm dhe procedurave të rregullta ligjore. Vërehet një abuzim me kompetencat dhe tendencë për të penalizuar subjektet doganore pavarësisht perfundimeve reale konkrete të kontrolleve perkatese.
- Pervecse verehen probleme ne lidhje me etiken profesionale, here here verehen edhe probleme ne lidhje me etiken personale te inspektoreve doganore, dhe te punonjesve te strukturave doganore, etj.

D. PROPOZIME PER NDRYSHIME NE LEGJISLACION

Nga anetaret e AmCham ka patur edhe konstatime dhe propozime konkrete ne lidhje me ndryshimet e pritshme te legjislacionit doganor:

- Aktet normative nenligjore te Keshillit te Ministrave, Ministrise se Financave, etj., qe kane te bejne me legjislacionin doganor duhet te rishikohen ne menyre qe te jene ne

perputhje dhe te mos tejkalojne dispozitat e parashikuara ne ligjet perkatese te miratuara nga Kuvendi i Shqiperise.

- Sugjerohet qe ndryshimi i nenit perkates te Kodit Doganor i cili parashikon si kusht per shqyrtimin e ankimit administrativ doganor, pagesën paraprake të detyrimit doganor, është thelbësor për shmangien e abuzivizmit në penalizimin e subjekteve doganore. Propozojmë që pagesa e detyrimit doganor per qellime te ankimit administrativ dhe gjyqesor perkates të jetë e detyrueshme për t'u paguar vetëm pasi vendimi i gjykates te kete marre formë të prerë.
- Sugjerohet ndryshimi i neneve perkatese te Kodit Doganor edhe per qellime te afateve te ankimit administrativ pasi gjykohet qe ato jane afate⁴ shume te shkurtra per te realizuar nje ankim administrativ efektiv.
- Miratimi i akteve nënljore me te detajuara të Kodit Doganor (përveç VKM nr. 205, datë 13.04.1999 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, i ndryshuar) ku të parashikohen qartësisht afatet e njoftimit, forma e akteve administrative, procedurat doganore, etj., do të shmangte interpretimet dhe zbatimin e gabuar të dispozitave ligjore dhe do të shmangte abuzivizmin.
- Publikimi i udhezimeve te Drejtorise se Pergjithshme te Doganave duhet te behet para dates perkatese te hyrjes ne fuqi.
- Legjislacioni doganor duhet ndryshuar në mënyrë që të përfshijë dispozita me te detajuara në lidhje me procedurat e konfiskimit të mallrave në doganë, ato të peshimit dhe ri-peshimit të mallrave.
- Hartimi i dispozitave ligjore dhe/ose nënljore te shprehura në lidhje me procedurat e eksportit për riparim. Më saktësisht, në rastet kur produkti i eksportuar nuk mund të riparohet dhe zëvendësohet me një produkt të ri me numër serial tjetër, per momentin ky zëvendësim krijon probleme me mbylljen e regjimit doganor perkates.
- Te rritet kufiri i vleres gjate importit te pakove qe kerkojne zhdoganim per qellime private personale pasi kufiri ekzitues eshte i ulet (10.000 Leke per dergese); kjo edhe per shkak te ndikimit qe ka ky kufi ne industrine postare.
- Ndryshimi i nenit 12/1⁵ të Kodit Doganor dhe qartësimi i shprehur në mënyrë që të lejohen subjektet të deklarojnë regjimin doganor përkatës edhe në zyrat doganore hyrëse përveç se në zyrën doganore kompetente për territorin ku është vendosur subjekti.

⁴ Shih nenin 289 pika 2 te Kodit Doganor.

- Eshte konstatuar praktika sipas se ciles aplikohet TVSH ne import edhe mbi vleren e akcizes; edhe sistemi elektronik doganor eshte i programuar ne menyre te tille qe TVSH ne import te aplikohet edhe mbi vleren e akcizes. Anetaret propozojne te behet ndryshim i legjislacionit ne menyre qe te menjanohet zbatimi i TVSH ne import edhe mbi vleren e akcizes.
- Te zgjaten afatet e tranzitit te cilat jane shume te shkurtra sidomos ne periudhen e dimrit per shkak te veshteresive ne qarkullimin rrugor.
- Per qellime te perjashtimeve nga TVSH ne import, te rimiratohet me vendim te Keshillit te Ministrave shtesa⁶, tashme e shfuqizuar, ne VKM nr.180 date 13.2.2003 e cila mundesoi pasurimin e listes se makinerive dhe pajisjeve qe jane te lidhura drejtperdrejt me investimin.
- Raportohet qe vlera e pullave fiskale eshte shume e larte (p.sh. tre deri kater here me e larte se ne Kosove).

⁵ Neni 12/1 parashikon se “Përveç rasteve të forcave mëdhore, plotësisht të dokumentuara dhe me përjashtim të regjimit të tranzitit dhe vendosjes së mallrave në qarkullim të lirë, deklarimi në doganë duhet të bëhet në zyrën doganore kompetente për territorin ku është vendosur personi”.

⁶ VKM nr.671 date 7.08.2013